



VENDIM

Nr. 3, Datë 10 / 01 / 2018

PËR

MIRATIMIN E RREGULLOREVE DHE KRITEREVE TË KONKURISIT TË PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019, TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në zbatim të, Nenit 38-Funksionet e Senatit Akademik, *e vijim* - të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", shkresës Nr. 132 prot., datë 29.12.2017, të Fakultetit të Arteve të Bukura, Senati Akademik i UART, pasi diskutoi mbi "Rregulloret dhe Kriteret e konkursit të pranimit për vitin akademik 2018-2019, të Fakultetit të Arteve të Bukura, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë "Bachelor" dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve" relatuar nga Dekani i FAB, Prof. Asoc. Ardian Isufi,

VENDOSI

1. Miratimin e "Rregulloreve dhe Kriterëve të konkursit të pranimit për vitin akademik 2018-2019, të Fakultetit të Arteve të Bukura, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë "Bachelor" dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve".
Bashkëlidhur, Rregullorja dhe kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të parë me kohë të plotë "Bachelor" si dhe Rregullorja dhe Kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve", të Fakultetit të Arteve të Bukura.
2. Ky Vendim, të publikohet në faqen zyrtare të UART.
3. Rregulloret dhe kriteret e konkursit të dërgohen zyrtarisht në MAS si dhe të përditësohen në portalin UALBANIA..

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Milto KUTALI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Najada HAMZAJ



Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Nansy GJERAZI

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Rafael HOXHA